

Date 17.09.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Sherbim

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “ Përmirosimi i sistemit të faturimit dhe sigurisë, moduleve të taksave, leximeve dhe pagesave me palët e treta, mirëmbajtje dhe monitorim i sigurisë së sistemit dhe moduleve”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- Sistem faturimi 48444100-3

VLERA E FONDIT LIMIT: 144.043.333,3 (njqind e dyzet e kater milion e dyzet e tre mije e treqind e tridhjte e tre presje tre) lekë pa tvsh.

Vlera e fondit Limit ne monedhen nderkombetare Euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte 1.450.879,67(nje milion e katerqind e pesedhjte mije e tetqind e shtatedhjte e nente presje gjashtedhjte e shtate) euro pa TVSH

Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes te Shqiperise datë 17.09.2024 është 99.28 euro.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar autoriteti/enti kontraktor UKT sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

B) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3 përkatësisht në vlerën 2.880.866,66 (dy milion e teteqind e tetedhjte mije e teteqind e gjashtedhjte e gjashte presje gjashtedhjte e gjashte) leke pa TVSH.*

Shuma e kerkuar e sigurimit te ofertes ne monedhen nderkombetare Euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte 29.017,59 (njezet e nente mije e shtatembedhjete presje pesedhjete e nente) euro pa TVSH.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

$$144.043.333,3 \times 40\% = 57.617.333,32$$

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne nenin 43 , pika 1 , pika 2 , si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise”, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike".

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2021, 2022, 2023) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet

të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. **Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.*

2.2.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njesite e veteqeverisjes vendore për vitin 2024)**, në të cilën është regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshilleve Bashkiake të njësive vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin.

(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

2.2.4. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024, të lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2024 sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të operatorëve ekonomikë të suksesshëm në marrëveshjen kuadër dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).*

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me vetëdeklarimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin në vazhdim sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për

“Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate përkatësisht jo më e vogël se 57.617.333,32 (pesedhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e treqind e tridhjetë e tre presje tridhjetë e dy) lekë pa tvsh.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në orgametat tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasishtë e mallrave të furnizuara,

për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasishtë e mallrave të furnizuara

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

- a) *Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:*

Vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar. Vlera për furnizime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoja duke patur parasysh objektin dhe vlerën e fondit limit.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

$$144.043.333,3 \times 40\% = 57.617.333,32$$

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i

përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001 (**ose ekuivalente**) (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).
- b) Operatori Ekonomik duhet të disponojë Çertifikatën ISO 27001 (**ose ekuivalente**), e vlefshme, mbi “Sistemet menaxhimit të sigurisë së informacionit”. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

ISO 27001 ose ekuivalent është i rëndësishëm për të siguruar menaxhimin të sigurisë së informacionit e cilësisë të shërbimeve që kërkohen dhe lidhen me sistemet e teknologjive të Informacionit. Ky lloj certifikimi garanton AK se operatori ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të sigurisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi.

2.5. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizimin e prodhuesit/distributorit të autorizuar për objektin e prokurimit ose kontratë bashkëpunimi me prodhuesin e sistemeve (komponenteve të projektit si meposhte).

- Për sistemin Server Cloud
- Për sistemin e bazës së të dhënave

- Për sistemin e bazave të të dhënave të hostuara;
- Për sistemin e hostuar të raportimit BI;
- Për sistemin Core Audit Application të bazës së të dhënave;
- Për sistemin AI-Billing në përdorim nga UKT;
- Për sistemin e Leximeve me PDA të ofruar;

Autorizimi (ose Kontrata e Bashkepunimit) duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Ne autorizimin e prodhuesit duhet të përcaktohet objekti i kësaj procedure dhe Nr references.

Argumentimi: Aktualisht shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Tirane (UKT) përdor sistemin e faturimit AI-Billing me të drejtë autori dhe bazuar në Ligjin Nr. 35/2016 "Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e tjera të Lidhura me to", Neni 48 "Kontrata e së drejtës së autorit", pika 4, ku kompania të ketë autorizim aktiv të vlefshëm me afat trevjeçar ose pesëvjeçar referuar kësaj pike.

Suporti i prodhuesit/distributorit të autorizuar, është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e licensave dhe shërbimeve që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre shërbimeve. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të shërbimeve që kërkohen të blihen e që janë krijuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar.

Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për tu garantuar që Operatori Ekonomik ka mbështetjen e prodhuesit për të garantuar cilësinë e produkteve dhe furnizimin e tyre në kohë për përmbushjen me sukses të kontratës, duke garantuar funksionimin e sistemeve në kushtet e garancisë dhe pas saj.

Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik".

Komponentet e mësipërm, vlerësohen si më të rëndësishmit e projektit të cilat duhet të kenë mbështetjen e prodhuesit.

2.6 Operatori ekonomik ofertues, duhet të ketë certifikimet si me poshte:

- Infrastruktura Cloud;
- Sisteme audit të dhenash;
- Sisteme Faturimi AI-Billing ose ekuivalent;
- Sisteme administrimi të Leximeve me PDA

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin certifikimet e marra nga prodhuesit e programeve dhe teknologjive që po ofertojnë, ose certifikimet ekuivalente, lëshuar nga autoritete të autorizuar/certifikuara për dhënien e tyre.

Argumentimi: Për këtë, vërejmë se sistemet kryesore në projekt janë Sistemi i faturimit AI-billing, Sistemi i Leximeve që do të ofrohet, Sistem Audit Baza të Dhënash, si edhe sistemet dhe

infrastruktura Cloud. Lidhur me zbatimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të mësipërme, prodhuesit e programeve informatike të mirënjohur ndërkombëtarë sikurse janë Oracle apo edhe të ngjashëm, kanë ndërtuar programe trajnimi dhe kontrolli të shoqërive të cilat mundet të kryejnë shërbime që lidhen me zbatimin apo mirëmbajtjen e këtyre sistemeve. Në kuadër të këtyre programeve prodhuesit vendosin kritere teknike; organizative për burimet njerëzore dhe për procedurat e brendshme të shoqërive. Këto programe/kushte ndërtohen nga vetë prodhuesit dhe ata në këtë mënyrë marrin përsipër cilësinë e shërbimeve të ofruara nga shoqëritë. Në shumë raste, kalimi i certifikimeve i kualifikon shoqëritë e IT si të autorizuar apo jo prej tyre për realizimin e shërbimeve të ndërhyrjes, përmirësimit apo përditësimit të sistemeve. Nëse shoqëritë nuk kanë certifikime të prodhuesit (për sisteme apo modulet) për ato ndërhyrje, cdo ndërhyrje në sistem rrezikon përfundimin e kushteve të garancisë apo të mirëmbajtjes së prodhuesit.

Për këtë, certifikimet e mësipërme që kanë lidhje me Modulet apo sistemet që kërkohet të prokurohet jo vetëm që përbëjnë një nevojë për garantimin e cilësisë së shërbimit, por ato janë direkt të lidhura edhe me kërkesat e prodhuesve për mirëmbajtjen. Ndërhyrje në sistem nga shoqëri të pa-certifikuara mundet të dëmtojë vetë sistemin, të dhënat që mbahen në sistem dhe/ose në kuadrin e sigurisë së informacionit, mundet të bëhet shkak për aksesin apo demtimin e informacionit në persona apo drejtime të paautorizuara.

Certifikimet e mësipërme, garantojnë autoritetin Kontraktor që shërbimet e përfshira në këte projekt/kontrate do të levrohen janë në përputhje me kërkesat e shoqërive prodhuese Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5 dhe 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.

2.7. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar prej te pakten 3 (tre) muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontrates, punonjes të diplomuar në fusha si shkenca kompjuterike, teknologji informacioni, inxhinieri informatike ose ekuivalent me keto, që do të angazhohen në implementimin e projektit, duke pasur certifikime të kombinuara sipas kërkesave të mëposhtme:

- a. Te pakten 2 (dy) punonjës, primar dhe backup, të certifikuar për programim ose implementim në sistemin e faturimit AL-Billing ose ekuivalent;
- b. Te pakten 2 (dy) punonjës, primar dhe backup, të certifikuar për programim ose implementim të sistemit të leximeve të ofruar;
- c. Te pakten 1 (një) punonjës të certifikuar për sistemin infrastrukture cloud të ofertuar;
- d. Te pakten 1 (një) punonjës të certifikuar për zgjidhjen BI të ofertuar;
- e. Te pakten 1 (një) punonjës të certifikuar për administrator sisteme baze të dhënash relacionale Oracle ose ekuivalent;
- f. Te pakten 2 (dy) punonjes të certifikuar për zhvillim në teknologji web;
- g. Te pakten 1 (një) punonjes të certifikuar për zhvillim në android ose ekuivalent;
- h. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për arkitekture orientuar nga shërbimet SOACP ose ekuivalent;

- i. Te pakten 2 (dy) punonjës të certifikuar për testues software;
- j. Te pakten 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhim projektsh PMP ose ekuivalent;
- k. Te pakten 1 (një) punonjës të certifikuar për ITIL ose ekuivalent për administrimin e shërbimeve IT;
- l. Te pakten 1 (një) punonjës të certifikuar për administrim të sistemit të operimit për servera si Linux, Windows server ose ekuivalent;
- m. Te pakten 1 (një) punonjës të certifikuar për të zhvilluar trajnime;

Një punonjës mund të posedojë më shumë se një certifikim.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin për punonjësit e sipërcituar dokumentacionin e mëposhtëm:

a. Certifikatat përkatëse të personelit. Në rast se certifikatat janë në gjuhë të huaj (te ndryshme nga ato të percaktuara në DT) operatori ekonomik duhet të paraqesë të përkthyer sipas dispozitave ligjore në fuqi.

b. Listëpagesën e 3 muajve të fundit.

Sqarim: përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin certifikimet e marra nga prodhuesit e programeve dhe teknologjive që po ofertojnë, ose certifikime ekuivalente lëshuar nga autoritete të autorizuar/certifikuara për dhënien e tyre nga prodhuesit e tyre ose të akredituara nga organizata akredituese.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

- a) Sistemi i faturimit ekzistues, ashtu sic është shpjeguar në specifikimet teknike perdoret prej shume vitesh nga UKT dhe është kritik për mbarevajtjen e aktivitetit të operacionit dhe ekonomik. Pas kaq shume vitesh perdorimi ai është ndryshuar e përmirësuar kohe pas kohe duke u përshtatur me nevojat e shoqërisë së bashku dhe specifikave që kanë shoqëritë në sektorin e ujësjellës kanalizimeve. Sistemi është kompleks dhe ka komponente të teknologjive të ndryshme nga të cilat përbehet të cilat duhet të mirë funksionojnë të asamblyuara së bashku sic janë tani. Nëpërmjet këtij kriteri të vecantë AK kërkon që OE të vejë në dispozicion një person i cili i ka aftësitë teknike për të nderhyrë teknikisht në këto sisteme për të realizuar kërkesat tona.

Meqenese ne po kerkojme zhvillime te reja dhe permiresime ne sistem, kerkojme qe keto aktivtete te kryhen nga profesioniste te certifikuar per tu garantuar per aftesite e tyre dhe te sigurojme qe nuk do te kete demtime te sistemit ekzistues, performances se tij dhe te dhenave te regjistruara ne te. Punonjesit me kete kapacitet jane shume te nevojshem edhe gjate fazes se mirembajtjes per zgjidhjen e te gjitha kerkesave qe mund te lindin gjate perdorimit te sistemit. Kerkohen te pakten 2 punonjes me kete certifikim per te garantuar prezencen dhe vijueshmerine e zbatimit te projektit dhe mirembajtjes edhe gjate periudhave te mungeses se perkohshme te personelit kryesor. Ne Tabelen e zerave kjo kerkese lidhet te pakten me zerin 1, 9, 10.

- b) *Sic shpjegohet ne specifikimet teknike, UKT kerkon te implementoje nje sistem te ri per mbledhjen e te dhenave te matesve dhe rreth taksave te abonenteve i cili do te funksionojë i integruar me sistemin ekzistues te faturimit. Ky sistem po ashtu eshte shume i rendesishem per UKT pasi procesi i leximeve (sic quhet shkurtimisht nga ne) eshte i domosdoshem per tu kryer sakt dhe ne kohe ne menyre qe te vijohet me proceset e tjera ne sistemin e faturimit. Fakti qe ne kete sistem punojne rreth nje numer i larte perdoruesish nga te cilet mbi 500 jane lexues te cilet mbledhin te dhenat ne terren me ane te App mobile dhe pajisjeve mobile dore PDA, kerkon qe sistemi jo vetem te plotesoje kerkesat teknike por edhe te konfigurohet e implementohet ne menyren e pershtatshme qe te ofroje performancen e pritur, sigurine e padiskutuar dhe te mire funksionojë i integruar me sistemin e faturimit. Proceset e konfigurimit dhe te implementimit mund te garantohen qe kryhen ne menyren e pershtatshme nga punonjes te cilet jane te certifikuar per kryerjen e tyre per ate zgjidhje. Per kete arsye ne kemi kerkuar qe OE te plotesoje kete kriter te vecante. Kryerja e ketyre proceseve nga persona te pacertifikuar mund te rrezikojë mos venien ne pune ne menyren e pershtatshme te kesaj zgjidhje per te permbushur nevojat dhe kerkesat tona. Punonjesit me kete kapacitet jane shume te nevojshem edhe gjate fazes se mirembajtjes per zgjidhjen e te gjitha kerkesave qe mund te lindin gjate perdorimit te sistemit. Kerkohen te pakten 2 punonjes me kete certifikim per te garantuar prezencen dhe vijueshmerine e zbatimit te projektit dhe mirembajtjes edhe gjate periudhave te mungeses se perkohshme te personelit kryesor. Ne Tabelen e zerave kjo kerkese lidhet te pakten me zerin 3, 9, 10.*
- c) *Sic eshte peshkruar edhe ne specifikime teknike, nje pjese e mire e komponenteve dhe zerave te kerkuar do te funksionojne ne cloud. Implementimi i tyre ne cloud dhe integrimi me komponentet qe do te jene lokalisht ne datacenter te UKT kerkon konfigurimet e pershtatshme per te garantuar siguri, qendrueshmeri, performance dhe aksesueshmeri. Keto konfigurime dhe implementime ne cloud ndryshojne nga ato qe kryhen infrastruktura lokale. Gjithashtu ato ndryshojne sipas llojit te sherbimit cloud qe do te perdoret. Punonjësi i certifikuar për sistemin cloud është gjithashtu njohës i mirë i suportit të këtyre sistemeve. Per kete, OE duhet të plotesoje kete kriter te vecante. Ne Tabelen e zerave kjo kerkese lidhet te pakten me zerin 6, 8, 9, 10.*
- d) *Sic eshte shpjeguar dhe ne specifikime teknike, UKT kerkon te implementoje nje sistem raportimi BI per te permiresuar marrjen e raporteve si ne cilesi ashtu edhe ne kohe. Implementimi i ketij sistemi kerkon njohuri specifike ne fushen e BI. Punonjesit me keto njohuri jane te domosdoshem ne disa faza te implementimit qe jane instalimi i sistemit,*

konfigurimi i pershtatshem, dizenjimi dhe ndertimi i raporteve qe te pershtaten me nevojat e UKT lidhur me menyren si paraqesin te dhenat, menyren se si i marrin ato dhe menyren se si i perpunojne ato per te qene te sakt, kuptimplote dhe te shpejt. Plotesimi i ketij kriteri nga nje punonjes i OE garanton edhe gjate periudhes se mirembajtjes zgjidhjen e kerkesave sic jane percaktuar ne specifikimet teknike. Ne Tabelen e zerave kjo kerkese lidhet te pakten me zerin 8, 9, 10.

- e) Baza e te dhenave eshte nje komponente shume e rendesishme e sistemit tone ekzistues Al-Billing. Sic eshte percaktuar ne specifikimet teknike baza e te dhenave eshte Oracle, per te cilen kerkohen te blihen edhe licensa. Nder te tjera ne jemi duke kerkuar edhe baze te dhenave te hostuar ne Cloud e cila eshte e integruar me bazen e te dhenave ekzistuese te Al-Billing. Kjo do te kerkoje instalim te baze se te dhenave ne Cloud, instalime dhe konfigurime te bazes se te dhenave ne datacenter lokal, instalim te licensave perkatese. Cdo veprim qe do te kryhet mbi bazen e te dhenave duhet patjeter te kete ne fokus sigurine dhe performancen. Per te gjitha keto arsye ne kemi kerkuar kete kerkese te vecante. Ne Tabelen e zerave kjo kerkese lidhet te pakten me zerin 4, 5, 7, 9, 10.
- f) Sistemi Al-Billing eshte i bazuar ne web html, javascript, css dhe shume prej permiresimeve e funksionaliteve te reja kerkojne programim edhe ne nderfaqen grafike te sistemit e cila eshte e bazuar ne web. Programuesit me njohuri ne programim web zbatojne teknika, teknologji dhe parime te ndryshme nga programuesit me njohuri ne aplikacione per desktop ose mobile. Per kete arsye UKT ka kerkuar kete kerkese te vecante. Kerkohen te pakten 2 punonjes me kete certifikim per te garantuar prezencen dhe vijueshmerine e zbatimit te projektit dhe mirembajtjes edhe gjate periudhave te mungeses se perkohshme te personelit kryesor. Ne Tabelen e zerave kjo kerkese lidhet te pakten me zerin 1 dhe 9.
- g) Sipas termave te references ne kerkojme implementimin e sistemit te Leximeve dhe Taksave e cila ka edhe App mobile. App mobile ne procesin e perdorimit te atij sistemi eshte shume i rendesishem. Gjate fazes se implementimit te sistemit, mund te linde nevoja e pershtatjeve ne App mobile per te permbushur te gjitha kerkesat qe kane perdoruesit. Edhe gjate fazes se mirembajtjes mund te linde nevoja zgjidhjes se kerkesave te caktuara te cilat mund te kerkojne nderhyrjen e nje programuesi ne App mobile ne perdorim nga lexuesit e UKT. Per keto arsye UKT ka kerkuar kete kerkese te vecante. Ne Tabelen e zerave kjo kerkese lidhet te pakten me zerin 3 dhe 9.
- h) Sistemi Al-billing, web sherbimet per komunikimet me bankat, sistemi i leximeve, te gjitha jane me arkitekture te orientuar nga sherbimet (Service Oriented Architecture). Komunikimi nepermjet web sherbimeve i ketyre sistemeve me njeri tjetrin ose me sisteme te jashtme, sic jane institucionet financiare banke dhe jo banke, jane kritike per mbarevajtjen e punes se sistemit si nje i tere dhe i aktivitetit operacional dhe ekonomik te shoqerise. Arkitektura e orientuar nga sherbimet ofron lehtesi dhe perparesi lidhur me mundesite qe ofron per te orkestruar dhe automatizuar proceset brenda nje sistemi dhe me sisteme te tjera te jashtme. Gjithashtu keto perfitime shkaktojne edhe mundesine e ekspozimit ndaj risqeve te sigurise. Per kete arsye kerkohet nje punonjes me certifiakte SOACP (Service Oriented Architecture Certified Professional) ose ekuivalent qe te mundesoje shfrytezimin e te gjitha avantazheve duke patur parasysh shmangien e te gjitha risqeve te sigurise. Per keto arsye UKT ka kerkuar

kete kerkese te vecante. Ne Tabelen e zerave kjo kerkese lidhet te pakten me zerin 1, 2, 3, 9, 10.

- i) Keto kerkesea mbeshteten ne termat e references se sherbimit, ku operatori duhet të jetë në gjëndje të përshtasë programin në komponentë të rëndësishëm të kërkuar nga UKT. Ne kete process permiresimi, operatori ekonomik duhet te jete ne gjendje te testoje ndryshimet, ofroje ndryshime me cilesi te larte dhe te garantoje impaktin minimal ne operimin e AL-Billing. Te gjithë zhvillimet dhe ndryshimet qe do te kryhen duhet te testohen perpara se te kalojne ne perdorim dhe keto testime qe te jene efikase duhet te ndiqen nga persona me njohurite dhe aftesite perkatese te cilat i garantojne te paturit te certifikates se kerkuar. Kerkohen te pakten 2 punonjes me kete certifikim per te garantuar prezencen dhe vijueshmerine e zbatimit te projektit dhe mirembajtjes edhe gjate periudhave te mungeses se perkohshme te personelit kryesor. Ne Tabelen e zerave kjo kerkese lidhet te pakten me zerin 1, 2, 3.*
- j) OE qe do te zbatoje realizimin e kerkesave qe vijne si rezultat i ketyre termave te references do te duhet te zbatoje nje projekt i cili ka aktivite qe kryhen ne paralel, aktivite qe kryhen ne seri dhe qe mund te jene bllokues per aktivitetet pasardhes. Njekohesisht OE do te duhet te menaxhoje marredhenien me furnitoret e vet qe jane prodhuesit ose distributoret e autorizuar per komponentet software qe do te dorezoje. Gjithashtu projekti ka zera me afate te ndryshme te cilat pritet qe te dorezohen nga OE. Miremanaxhimi i ketij projekti kompleks kerkon nje menaxher projekti i cili garanton zbatimin ne cilesi dhe ne kohe te ketij projekti. Ne Tabelen e zerave kjo kerkese lidhet me cdo ze.*
- k) Sipas kerkesave te percaktuar ne termat e references per detyrat qe pritet te realizohen nga OE gjate fazes se mirembajtjes, jane nje sere detyrash periodike te cilat OE duhet ti kryeje per te parandaluar probleme te mundshme ne sistem dhe jane disa aktivite te cilat lindin nga zbulimi i problematikave nga ana e perdoruesve te cilet do ti raportojne dhe do te presin zgjidhjen nga ana e OE. Keto aktivite parandaluese dhe zbatimi i kohes se pergjigjes lidhur me zgjidhjen e problemeve te raportuara kerkojne nje mire administrim per te shmangur humbjen e kohes nga mos rakordimi i paleve te perfshira ne projekt. Rolin e koordinimit te paleve gjate fazes se mirembajtjes dhe garnatimin e zbatimit te kohes se sherbimit e kryen te pakten nje punes i certifikaur ne ITIL ose ekuivalent. Ne Tabelen e zerave kjo kerkese lidhet te pakten me zerin 9.*
- l) Permiresimet qe kerkohen te kryhen ne software AL-billing, instalimi i software te rinj sic jane ai i Auditit te bazes se te dhenave, Sistemi i leximeve dhe taksave, Instalimi i zgjidhjes BI, instalimi i web sherbimeve, kerkojne qe sistemi i operimit ne serverat ne datacenter lokal te UKT dhe sistemi i operimit ne cloud e ofertuar nga OE te konfigurohen per t'iu pershtatur kekresave tona dhe menyres se zgjidhjes se tyre nga ana e OE. Sistemi i operimit eshte shume i rendesishem per mbarevajtjen e sistemit si ne fazen e dorezimit fillestar ashtu edhe gjate fazes se mirembajtjes. Konfigurimi i pershtatshem i sistemit te operimit eshte i rendesishem per sigurine e sistemit si lidhur me menyren e aksesimit te perdoruesve ne te gjate fazes se instalimit, gjate fazes se mirembajtjes ashtu edhe ne komunikimet qe kane sistemet me njeri tjetrin. OE duhet qe te kete ne skuader nje punonjes te certifikaur sipas kesaj kerkese per te garantuar instalimin e komponenteve te sistemit, mirembajtjen e tyre dhe konfigurime te tjera*

qe mund te duhet te kryhen gjate 3 viteve te mirembajtjes. Ne Tabelen e zerave kjo kerkese lidhet te pakten me zerin 1, 2, 3, 9.

- m) *Ne dorezim te sistemeve ne kerkojme qe perdoruesit te trajnohen per perdorimin e tyre. UKT ka nje numer te konsiderushem perdoruesish dhe trajnimi i te cileve duhet te mire organizohet pasi nuk mund te kryhet i gjithi brenda nje dite. Gjithashtu, perdoruesit kane role te ndryshme ne sisteme dhe per kete arsye trajnimi duhet te organizohet i tille qe ti pershtatet rolit te tyre. Trajnimet qe nuk fokusohen tek tipi i perdoruesve qe do te marrin pjese dhe qe kryhen ne menyre siperfaqesore me materiale te ceketa e te pa perditesuara mund te shkaktojne humbjen e kohes per te gjitha palet dhe krijimin e konfuzionit duke rrezikuar ne te njejten kohe edhe mbarevajtjen e vet procesit te dorezimit dhe te venies ne pune te sistemeve te reja. Per kete arsye OE duhet te angazhoje te pakten nje punonjes te certifikuar sipas kerkeses se vecante qe te garantoje krijimin e mterialeve te pershtatshem te trajnimeve dhe kryerjen e sukseshme te trajnimeve per te gjitha perdoruesit. Ne Tabelen e zerave kjo kerkese lidhet te pakten me zerin 10, 11.*

2.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, lidhur me produktet software te gatshem duhet të paraqesë Materiale teknike të prodhuesit (katalog teknik per produktet standarde te ofruara si database, partitioning, Audit Log, Sistem BI, Sistemi i leximeve, etj);

Gjithashtu App mobile i sistemit te leximeve duhet te jete i certifikuar nga te pakten nje prodhues pajisjesh mobile PDA. Ne certifikate te konfirmohet qe App mobile i zgjidhjes se ofruar eshte i pershtatshem per PDA e atij prodhuesi. Certifikata te jete leshuar brenda 3 viteve te fundit nga dita e shpalljes se kesaj procedure.

Argumentim: *Ne termat e references, pasqyruar edhe ne Tabelen e zerave, kerkohen te dorezohen zera te cilet jane produkte software te gatshem te cilat kane prodhues ose distributor te autorizuar. Keot componente te gatshme si baza e te dhenave, auditi i bazes se te dhenave, baza e te dhenave ne cloud, sistemi i raportimit BI, sistemi i leximeve me pajisje PDA, etj, perbejne nje pjese shume te rendeishme te projektit. Keto mallra jane te gatshem dhe per kete arsye, prodhuesit e tyre kane katalogje zyrtare qe permbajne vecorite dhe funksionet e tyre. Meqenese ato jane produkte te gatshem, atehere kerkohen keto dokumenta leshuar nga prodhuesi, lidhur me funksionet dhe vecorite qe ofrojne ne menyre qe komisioni i vleresimit te ofertave te kete mundesi te vleresoje nese ato i permbushin kerkesat e percaktuara ne termat e references. Ne mungese te tyre komisioni i ka te pamundur te beje vlresimin e permbushjes se kereksave te ketyre mallrave, ne menyre te vecante verifikimin e sigurise se ketyre mallrave.*

Sic eshte shpjeguar edhe ne specifikime teknike, edhe ne argumentimet e kerkesave te mesiperme, App mobile eshte nje mjet shume i rendesishem ne te cilin bazohet puna e operatoreve te leximeve te cilet zbatojne detyrat e tyre ne terren dhe kerkohet qe App mobile te shfrytetoje pajisjen PDA. Ne menyre te vecante certifikimet vertetojne se ne kapacitetin maksimal te perdorimit respektohet gjithashtu burimi i energjise se PDA duke mos e shkarkuar baterine ne menyre agresive. Ne teresi PDA ka burime te ndryshme te cilat perdoren nga App mobile si psh, kujtesa, GPS, kamera, sherbime te tjera qe ofron sistemi i operimit. Meqenese App mobile i kerkuar eshte i destinuar per tu perdorur per qeillim te mirepercaktuar, pajisjet mobile PDA gjithashtu perdoren vetem si mjete pune dhe kane qeillim te mirepercaktuar, te gjitha aspektet te cilat jane te rendesishme per tu respektuar garantohen me se miri kur prodhuesi i pajisjeve mobile PDA e ka testuar dhe certifikuar ate.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Në specifikimet teknike (pjesë e DST-së) janë përcaktuar edhe arsyet e vendosjes të specifikimeve teknike.